



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.10.2018 ora 18.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Paraqitja e projektligjit të buxhetit të shtetit 2019 dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtë për drejtë me të nga ministri i Financave;
2. Miratimi i kalendarit të veçantë të shqyrtimit të projektligjit të buxhetit të shtetit 2019 dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtë për drejtë me të.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Blendi Çuçi -	Nënkryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Eliza Spiropali -	Nënkryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike

Petrit Vasili - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim / Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Mimoza Pano – Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, para dy ditësh, më 29 tetor, qeveria ka depozituar në Kuvend projektligjin për buxhetin e vitit.

Bazuar në nenin 79 të Rregullores, kam thirrur sot këtë mbledhje të Konferencës së Kryetarëve me rend dite:

Së pari, paraqitjen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë të projektligjit të buxhetit të shtetit për vitin 2019, si edhe të projektligjeve financiare, që shoqërojnë atë.

Së dyti, sipas Rregullores, miratimin e kalendarit të veçantë të shqyrtimit të projektligjit në buxhetin e shtetit për vitin 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të, në komisionet e përhershme dhe në seancën plenare, i cili do të kalojë për miratim në seancën e ditës së nesërme.

Siç e dini, sapo projektbuxheti të paraqitet në parlament, futet automatikisht në programin aktual të punës së Kuvendit dhe po sipas Rregullores Kuvendi miraton një kalendar të posaçëm shqyrtimi, të cilën e propozon kryesia e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. E keni të gjithë përpara dhe do ta diskutojmë pasi të dëgjojmë prezantimin e buxhetit.

Në mbështetje të nenit 79, pika 2, të Rregullores, ftoj ministrin e Financave dhe të Ekonomisë të paraqesë projektbuxhetin dhe paketën fiskale që e shoqëron atë.

Zoti Ahmetaj, fjala për ju.

Arben Ahmetaj – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare dhe komisioneve kuvendore,

E nderuar zëvendëskryeministre,

Projektbuxheti i vitit 2019, që është vënë në dispozicion për shqyrtim, vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit, ndërkohë që vijon konsolidimi fiskal, duke ulur më tej barrën e borxhit publik për biznesin dhe qytetarët.

Rritja ekonomike parashikohet në nivelin 4,3% për vitin 2019, dhe pritet të forcohet më tej në vitet 2020 dhe 2021.

Raporti i borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto do të ulet 66,9 në fund të vitit 2018, duke iu referuar borxhit neto, dhe 64,9 në vitin 2019, duke synuar 60% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2021.

Rritja domethënëse ekonomike e parashikuar për vitin 2019 krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 30 mijë vendeve të reja të punës të planifikuara duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë nën 12% të forcës aktive për punë në vitin 2019, krahasuar me 12,9% që planifikohet mesatarja e këtij viti.

Në këtë kontekst projektbuxheti i vitit 2019 do të vijojë të mbështesë krijimin e vendeve të reja të punës me politika incentivuese fiskale, si edhe me një skemë më efektive të punësimit dhe aftësimit profesional.

Rritja ekonomike pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme si konsumi privat dhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto pra eksporti dhe importi pritet të sjellë, gjithashtu, një impakt pozitiv, por akoma marxhinal.

Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si edhe nga përmirësimet në tregun e punës. Ndërsa rritja e investimeve pritet të rritet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si edhe nga përsheptimi i aktiviteteve ekonomike gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme dhe afatgjatë.

Njëkohësisht edhe vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies pritet të jetë një faktor incentivues i investimeve private afatmesme. Politika fiskale do të vazhdojë drejt konsolidimit në periudhën afatmesme, e rrjedhimisht me efekt direkt neutral mbi konsumin, por politika buxhetore e sigurimit të një niveli prej rreth 5% të prodhimit të brendshëm bruto të investimeve publike, do të mbështesë krijimin e konsiderueshëm të kapitalit fiks bruto në ekonomi, i cili është i rëndësishëm për të mbajtur nivele relativisht të larta rritjeje si në afatshkurtër ashtu edhe në afatgjatë.

Në të njëjtën kohë qëndrimi akomodues i parashikuar i politikës monetare për periudhën afatmesme, për sa kohë që presionet inflacioniste mbeten në kahun e poshtëm, pritet të mbështesë, gjithashtu, konsumin privat dhe investimet. Efekti tjetër indirekt që vjen prej konsolidimit të

stabilitet makro-ekonomik dhe besimit të agjentëve në ekonominë e vendit, reduktimit të primeve të riskut, si dhe krijimit të një hapësire më të madhe për financim dhe zgjerimin e sektorit privat pa dyshim, që është një efekt tjetër pozitiv në performancën e ekonomisë në tërësi. Rritja në periudhën afatmesme pritet të jetë e orientuar drejt krijimit të vendeve të punës krahasuar me historikun, pasi sektorët e prodhimit më intensiv të forcës së punës pritet të performojnë relativisht më mirë se të tjerët. Shkalla e papunësisë përllogaritet të zbresë në 12% për vitin 2019 dhe të vijojë gradualisht rënien në vitet në vijim, drejt njëshifrorit.

Sa i takon objektivit madhor të konsolidimit fiskal, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj disa aspekte kyçe që projektbuxheti 2019 bart: një deficit fiskal, që për herë të parë programohet nën -2% të prodhimit të brendshëm bruto, pra 1,9%, ndërkohë që në periudhën afatmesme pritet të ulet akoma më shumë deri në 1,2% të prodhimit të brendshëm bruto në 21-in; 1,9% për vitin 2019, i cili është deficit i më i ulët historik i programuar, bilanc primar që për katërtin vit radhazi është pozitiv, duke shënuar +0,5% të prodhimit të brendshëm bruto, pra me suficit, për vitin 2019, i cili pritet të jetë akoma edhe më i lartë në vitet pasuese; bilanc korrent me suficit të konsiderueshëm me mbi 3% të prodhimit të brendshëm bruto në periudhën 2019-2021, i cili përkthehet në një qeveri të përgjegjshme, që financon tërësisht operacionet e veta nga të ardhurat buxhetore dhe financim i investimeve publike me një shifër të konsiderueshme nga të ardhurat buxhetore me mbi 3% të prodhimit të brendshëm, ndërkohë që pjesa tjetër do të financohet nëpërmjet huave.

Ky është rregulli i artë që i referohet bilancit korrent dhe tregon pozitivitetin në qasjen e buxhetit 2019-të, por edhe përgjegjshmërinë e qeverisë në menaxhimin e financave publike. Për rrjedhojë, niveli i borxhit publik do të vijojë të ulet gjithnjë e më shumë në nivele më të sigurta dhe më pak të kushtueshme për ekonominë dhe shqiptarët.

Të ardhurat buxhetore për vitin 2019 janë parashikuar me rritje, duke marrë parasysh faktorë të tillë si rritja ekonomike dhe indeksi i çmimeve, politikat e reja fiskale, si dhe efektet nga lufta kundër informalitetit, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin. Të ardhurat buxhetore në fund të vitit 2018 pritet të jenë 458,2 miliardë lekë, krahasuar me vitin 2017 parashikohet një rritje prej 6,5% ose 27,8 miliardë lekë, duke kapur nivelin 27,8% të prodhimit të brendshëm bruto nga 27,7 që ishim në 2017. Rritja me 0,1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me produktin e brendshëm bruto për vitin 2018, është një tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike.

Kjo rritje vjen kryesisht si rrjedhojë e rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave, pavarësisht efekteve tejet negative të kursit të këmbimit në të ardhurat nga importi. Dëshiroj të ilustroj këtu vetëm efektin negativ që ka pasur kursi i ulët i këmbimit euro/lekë në të ardhurat e pritshme nga TVSH-ja, ku për 9-mujorin e vitit 2018 përlllogaritet në një vlerë të konsiderueshme prej 6 miliardë lekësh më pak, ndërkohë që prognoza deri në fund të vitit shkon në 9 miliardë lekë.

Paketa fiskale 2019 synon arritjen e disa objektivave: uljen e barrës tatimore për grupe të caktuara individësh, si të punësuarit me nivel të mesëm pagash; uljen e barrës së kombinuar fiskale mbi fitimin dhe dividendin për kompanitë; dhënien e incentivave dhe stimujve tatimorë për industri dhe sektorë të caktuar si bujqësia, fasoneria, farmaceutika e të tjerë; stimulimin e politikave në transport, në funksion të mbrojtjes së ambientit dhe rregullime të barrës fiskale në fushën e mallrave të akcizës.

Paketa fiskale për vitin 2019 parashikon ndryshimet e mëposhtme:

Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”

1. Ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.
2. Rritja e kufirit të pagës që tatohet me 23 % nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë.
3. Dispozitë taksimi për fitimet kapitale jorezidente, në lidhje me shitjet e kuotave të kompanive apo aktiveve që ndodhen në Shqipëri. Kjo është një masë antievazion, në harmoni të plotë me zhvillimet e fundit që ka avancuar OECD-ja.

Ligji “Për taksat nacionale”

1. Kalimi nga taksimi i ambalazheve plastike tek taksimi i materialeve plastike; ulje e masës së taksës me 2/3, ulje me 50 % edhe e masës së taksës për ambalazhet e qelqit.
2. Rritja e rentës minerare për eksportin e kromit nga 6% në 9%, si dhe heqja e taksës së karbonit për eksportin e naftës.

Ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”

1. Përfshirja në import i lëndëve të para për fabrikat e prodhimit farmaceutik.
2. Përfshirja nga TVSH-ja i furnizimit me shërbim nga nënkontraktorët për kontraktorët në industrinë fason.
3. Përfshirja nga TVSH-ja i importit të makinerive bujqësore, sipas listës së miratuar me VKM nga çdo importues;
4. Normë e reduktuar TVSH-je 10% për importin e autobusëve elektrikë të transportit publik.
5. Normë e reduktuar 6% për shërbimin e reklamave nga televizionet.

Ligji “Për akcizat”

6. Vendosija e akcizës 1 lekë/kilogram për zhavorret bituminoze, që përdoren si lëndë djegëse alternative.

7. Heqja e akcizës për fishekzjarret, llambat, pilat/bateritë.

8. Rritja e akcizës për duhanin e përpunuar dhe zëvendësuesit e tij, duhanet me ngrohje ose purot.

Ligji “Për procedurat tatimore”

1. Dispozitë antishmangie e përgjithshme nga taksat, në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian.

2. Dispozitë antishmangie në lidhje me regjistrimin e më shumë se një biznesi nga personat fizik tregtar.

3. Lehtësim i procedurave të çregjistrimit të biznesit.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2019 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura, të cilat do të stimulojnë më tej rritjen ekonomike të vendit, duke gjeneruar njëkohësisht punësim. Gjithashtu, mbështeten një sërë reformash, nga ajo e drejtësisë te reforma e ujit.

Për vitin 2019 shpenzimet buxhetore do të kapin për herë të parë vlerën absolute prej 519,4 miliardë lekësh ose 29,6% e PBB-së. Krahasuar me të pritshmin e vitit 2018, totali i shpenzimeve buxhetore programohet me rritje 5,9% më shumë.

Shpenzimet e personelit të planifikuara në masën 80,6 miliardë lekë për vitin 2019, përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, mbartin dhe reflektojnë koston aktuale të administratës publike, mbartin gjithashtu dhe politikën e rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë 7%, arsimin 7%, mbrojtjes 7%, sistemit penitenciar 7% dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike 20%. Në këto shpenzime planifikohet kostoja e plotë e reformës në drejtësi, për akomodimin e pagave të reja të institucioneve aktuale të sistemit të drejtësisë, si dhe akomodimin e institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e kësaj reforme. Vlen të theksohet se nga kjo rritje e konsiderueshme e pagave përfitojnë: 4650 mjekë, 13765 ndihmës mjekë, pra infermierë, 35783 mësues, 6,800 ushtarakë, 3559 efektivë të policisë së burgjeve dhe 308 diplomatë.

Shpenzimet Operative dhe Mirëmbajtjes do të kapin vlerën 48.6 miliardë lekë, duke prioritetizuar mbështetjen e skemës së fermerëve, me një rritje në dy vjetët e fundit me 2.6 miliardë lekë, mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar rrugor, ky është viti i dytë ku do të kemi shumë të strukturuar

midis Bankës Botërore dhe burimeve të brendshme të konsiderueshme për mirëmbajtjen e rrugëve dhe mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike.

Shpenzimet për interesa planifikohen 41.7 miliardë lekë ose 2.4% të prodhimit të brendshëm bruto, për të përballuar një rritje të mundshme të normave të interesit 1 deri në 2 pikë përqindje, duke iu referuar edhe sinjaleve të fundit si nga Banka Qendrore Europiane, ashtu edhe nga Banka Qendrore Amerikane apo Federal Reserve.

Subvencionet parashikohen me ulje në terma absolutë dhe relativë, krahasuar me një vit më parë, ku planifikohet rreth 1.5 miliardë lekë ose 0.1% të prodhimit të brendshëm bruto. Kjo ulje vjen si pasojë e rialokimit të një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, tek investimet publike në rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve në kuadër të përshpejtimit të reformës së ndërmarrë nga qeveria për këtë sektor jetik. Kjo do të thotë se subvencioni nuk do të jetë më një subvencion pasiv dhe të financojë kostot, por do të financojë investimet.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 179.98 miliardë lekësh për vitin 2019.

Dua t'ju tërheq vëmendjen në një fakt mjaft pozitiv dhe interesant për sa i përket fondit të kompensimit të ish-pronarëve. Për herë të parë, në buxhetin e vitit 2019 do të jetë një shumë prej 5 miliardësh e nominuar, në bazë të ligjit që kemi hartuar për trajtimin e ish-pronarëve me kompensim fizik, apo monetar, e cila nuk do të jetë objekt i deficitit buxhetor. Kjo do të thotë që, pavarësisht se kjo shumë mund të mos jetë harxhuar deri në fund të vitit fiskal 2019, pjesa e mbetur do të jetë e trashëgueshme për vitin 2020 e kështu me radhë, në mënyrë që fondi për kompensimin e ish-pronarëve të mos preket në varësi të fluktuimit potencial të deficitit.

Skema e sigurimeve shoqërore. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2019 parashikohet në shumën 130.63 miliardë lekë ose 7.5% të prodhimit të brendshëm bruto. Ky raport është i njëjtë me vitin 2018, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2.45 miliardë lekësh. Duhet theksuar se krahasuar me vitin 2013, skema e pensioneve i rëndon më pak buxhetit të shtetit, pasi në vitin 2013 transferta buxhetore zinte rreth 46,2% të totalit të shpenzimeve, ndërkohë që për vitin 2019 parashikohet të zërë 35,6% të totalit. Ky është një përmirësim i ndjeshëm, që ka ardhur si pasojë e dy faktorëve kryesorë: uljes së nivelit të informalitetit në tregun e punës dhe rritjes së nivelit të punësimit dhe kontribuesve. Skema e sigurimit të kujdesit shëndetësor për vitin 2019 është parashikuar 41.9 miliardë lekë ose 2,4% e GDP-së nga 40,4 miliardë lekë në vitin 2019. Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve

parashikohet, siç e theksova më lart në total në masën 5 miliardë lekë ose 0.3% e GDP-s. Duke filluar nga viti 2016 fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga viti në vit duke synuar në vitin 2021 shumën 5,5 miliardë lekë krahasuar me 1,89 miliardë lekë që ishte në vitin 2013. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga kjo qeveri për trajtimin e ish- pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10- vjeçare të parashikuar edhe në ligjin nr.133 të vitit 2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”. Shpenzimet e tjera sociale përfshijnë pagesën e papunësisë, parashikohen në nivelin 500 milionë lekë. Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 20,5 miliardë lekë në të njëjtin nivel si viti 2018, për ish- të përndjekurit është parashikuar një fond prej një miliardë lekësh ose 0,1 % e GDP-së, për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh ose 0,1 % e GDP-së. Nga kjo politikë e re pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje gjatë vitit 2019. Kjo është edhe një nga reagimet e para që ka qeveria për sa i përket rrezikut, riskut të uljes së ritmit të lindjeve, riskut demografik.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2019 planifikohet në masën 3 miliardë, përkatësisht: 1,5 miliardë lekë fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 1,5 miliardë lekë fond kontigjencë për financimin e pagave të reja për magjistratin, si dhe ngritjen e funksionimit të institucioneve të reja të drejtësisë midis tyre Byroja Kombëtare e Hetimit dhe SPAK-u.

Investimet publike për vitin 2019 janë planifikuar në masën 5,1% e GDP-së ose 88,8% miliardë lekë, përfshirë edhe mbështetjen për sektorin e energjisë 3 miliardë lekë në formën e investimeve të huaja apo siç i referohemi teknikisht pozicionit neto të sektorit të energjisë, reflektuar brenda deficitit buxhetor.

Për sa i përket mbështetjes së sektorëve prioritarë dëshiroj ta filloj me arsimin, ku synojmë të mbajmë një nivel konstant në raport me prodhimin e brendshëm bruto prej 3% përgjatë periudhës 2019-2021. Përveç rritjes së pagave të parashikuara për mësuesit në vitin 2019 në këtë sektor do të financohet me përparësi ofrimi i teksteve shkollore falas për 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar, nga të cilët 125 mijë nxënës të klasave nga e para deri tek e katërta. Kostoja vjetore do të jetë nga 610 milionë deri në 700 milionë lekë në vit. Transporti i siguruar për 28 mijë nxënës që kanë vendbanimin mbi 2 kilometra nga shkolla, si edhe për 10 mijë mësues që punojnë mbi 5 kilometra nga vendbanimi, qendra e përhershme e punës në shkollë. Kostoja vjetore shkon 650 deri në 680 milionë lekë në vit. Për 1000-1400 nxënës të arsimit parauniversitar, nga shtresat sociale në nevojë, do të garantohet trajtimi me kuotë ushqimore. Për arsimin bazë, ndërtime të reja dhe shtesa objektesh, 15-20 objekte shkollore në vlerën 800 milionë

lekë, pra 400 milionë lekë në vit. Rikonstruksione: 90-100 objekte shkollore, me një vlerë 2, 5 miliardë lekë, 1, 25 miliardë lekë vetëm në vitin 2019.

Për arsimin e mesëm të përgjithshëm, ndërtime të reja dhe shtesa objektesh: 6 deri në 10 objekte shkollore me vlerë 660 milionë lekë, nga të cilat 300 milionë lekë vetëm vitin që vjen. Rikonstruksione të rreth 40 objekteve shkollore, me vlerën 1, 5 miliardë lekë, 0, 75 miliardë lekë vetëm për vitin 2019.

Në shëndetësi financimi do të ngelet mesatarisht në nivelin 2, 9 % në periudhën 2019 – 2021. Përveç rritjes së pagave për mjekët dhe infermierët, do të synohet reduktimi në më pak se 15 % i numrit të pacientëve të rishtuar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orëve, nëpërmjet urgjencës; reduktimi i kohës së pritjes për ekzaminime të rëndësishme, rezonancë magnetike, skaner, në më pak se 45 ditë; reduktimi i indeksit të vdekshmërisë foshnjore për periudhën 2019 – 2021, në më pak se 5, 3 në 1000 lindje; garantimi i mbulesës vaksinave; 200 qendra shëndetësore të rikonstruara dhe të pajisura, nga 100 në çdo vit, 2019 e 2020.

Lidhur me skemën e rimbursimit të barnave, kemi konstatuar se kjo skemë po ecën përtej mundësive që parashikonte buxheti, me një rritje prej 23, 6 % për periudhën 2019 – 2021, e kësaj ka nevojë për një reformë, e cila sjell eficiencë dhe efektivitet më të lartë të kësaj skeme.

Për këtë qëllim, në nenin 5 të projektligjit të buxhetit 2019, që përcakton buxhetin e FSDKSH-së, kemi propozuar vënien e një tavani shpenzimesh për këtë skemë, me vlerën 10, 5 miliardë lekë, për të incentivuar më tej ndërmarrjen e kësaj reforme të domosdoshme.

Bujqësia do të vazhdojë të përfitojë në terma realë 0, 6 % të prodhimit të brendshëm bruto për periudhën 2019 – 2021, e me këtë synohet rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore, që i afrohet shërbimit të ujitjes, nga 65, 3 % në 2019 në 68, 1 % në vitin vijues, me rreth 360 mijë hektarë tokë në vitin 2021.

Numri i fermerëve të mbështetur nga skemat kombëtare, mesatarisht 3600 përfitues në vit, me kosto vjetore 2, 6 miliardë, siç e theksova më lart. Fillimi i skemës së IPARD-it do ta rrisë më tej këtë numër përgjatë viteve 2019 – 2021. Rritja e sipërfaqeve të mbjella me dru frutorë, nga 36, 1 mijë hektarë në vitin 2019, në 38 mijë hektarë në vitin 2021. Rritja e sipërfaqes së mbjellë me perime në serra, nga 1750 hektarë në vitin 2019, në 2010 hektarë në vitin 2021.

Infrastruktura do të përfitojë fonde të konsiderueshme përgjatë 2019 – 2021, me rreth 2, 8 % të prodhimit të brendshëm bruto për 2019 – 21. Synohet kompletimi i akseve rugore nacionale, si Rruga e Arbrit, rruga Thumanë – Vorë – Kashar, rruga Milot – Balldren, rruga Orikum – Dukat brenda vitit 2021, me projektin 1 miliard, si dhe potencialisht rruga Tiranë –

Durrës, për zgjerimin me tri korsi, pra në total me gjashtë korsi, të aksit kryesor të vendit, si dhe vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm nëpërmjet një aksi të ri Vorë – Rrogozhinë.

Kompletimi i pjesës dërmuese të segmenteve rrugore në vazhdim, me financim të brendshëm gjatë vitit 2021, si Kardhiq-Delvinë, Elbasan-Banjë, bajpasi i Shkodrës; bajpasi i Tepelenës, një pjesë e mirë e unazës së Tiranës.

Kompletimi i segmenteve rrugore brenda vitit 2021 me financim të huaj, si bajpasi i Fierit, që mendohet të bëhet i kalueshëm para verës 2019, bajpasi i Vlorës dhe Qukës-Qafë Plloçë.

Ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetësh njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 23%, që ka të bëjë me output-in.

Fondi i mirëmbajtjes së rrugëve 2019-2021, është më i larti i 25 vjetëve të fundit, rreth 3, 7 miliardë lekë mesatarisht.

Vënia në funksion e aeroporteve të Vlorës dhe Kukësit nëpërmjet skemave të partneritetit publik privat.

Furnizimi 24 orë me ujë dhe shërbime për zonën bregdetare brenda vitit 2021.

Në vitin 2020 parashikohet të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38%, kundrejt vitit 2009.

Në vitin 2021 synohet të riciklohet rreth 20 % e totalit të mbetjeve të prodhuara nga 0, 05, që parashikohet në vitin 2018.

Shpenzimet për buxhetin vendor për të tretin vit radhazi do të vazhdojnë të mbështesin reformën administrativo-territoriale dhe reformën e decentralizimit.

Në projektbuxhetin e vitit 2019 burimet e financimit të vetëqeverisjes vendore do të rriten me rreth 5 miliardë lekë ose 11 % më shumë se ato të vitit 2018, të cilat do të shkojnë për më shumë investime dhe përmirësime të shërbimeve publike.

Ndër masat më të rëndësishme përmendim miratimin dhe zbatimin e ligjit të vetëqeverisjes vendore dhe reformën për taksën e ndërtesave me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale. Të gjitha këtu dëshmojnë vullnetin dhe seriozitetin e qeverisë për zbatimin e reformës administrative territoriale.

Transferta do të jetë 1% e prodhimit të brendshëm bruto.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2019 janë parashikuar në masën 51,14 miliardë lekë, të cilat zënë 2,9% të prodhimit të brendshëm bruto, nga 2,3% që zinin në vitin 2013. Pjesa më e madhe, mbi 60% e këtyre shpenzimeve, shkojnë për investime dhe shërbime publike për komunitetet vendore.

Burimi i zgjerimit të shpenzimeve vendore për vitin 2019 është rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e veta, si dhe nga rritja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 parashikohen të kenë një rritje me mbi 3,8 miliardë lekë më shumë sesa plani i vitit 2018, ose, thënë ndryshe, me një rritje prej rreth 21%. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2015, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth 90 %.

Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta, si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, reforma që ka filluar në taksën e pronës, konkretisht për taksën mbi ndërtesat dhe ngritjen e kadastrës fiskale, parashikohet të ndikojë ndjeshëm në rritjen e të ardhurave në buxhetin vendor për vitin 2019 dhe për vitet e tjerë në vazhdim.

Në buxhetin vendor të vitit 2019, në vijim të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë reforma e financimit të arsimit parashkollor.

Për vitin 2019, fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 9,1 % në krahasim me vitin 2018. Në të njëjtën kohë do të përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive.

Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ku fondet ndaheshin sipas numrit të edukatorëve, konform praktikave më të mira ndërkombëtare, financimi i këtij funksioni në vitin 2019 do të bazohet kryesisht në numrin e nxënësve/fëmijëve 3 deri në 6 vjeç, si një kriter më objektiv për përcaktimin e nevojave për shpenzime. Kështu që 60 % e transfertës për arsimin parashkollor do të ndahet bazuar në numrin e fëmijëve 3-6 vjeç dhe 40 % do të vazhdojë të ndahet mbi numrin e edukatorëve, pra një kombinim. Nga kjo reformë, në buxhetin e vitit 2019, nuk do të ketë asnjë bashki që humbet fonde. Përkundrazi, pjesa më e madhe e bashkive do të jetë fituese në fonde për këtë shërbim. Si rrjedhojë e kësaj reforme do të punësohen 438 edukatorë më shumë sesa në vitin 2018, të cilët do të shkojnë në 32 bashki, që kanë nevojë më të madhe për shtimin e edukatorëve, e matur nga raporti që unë përmenda më lart “fëmijë për edukatorë” dhe jo e kundërta, “edukatorë për fëmijë”. Kjo reformë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e madhësisë maksimale mesatare të grupeve në kopshte, nga 26 në 18 nxënës për edukator dhe të madhësisë mesatare kombëtare nga 18 në 15 nxënës për edukator, duke krijuar kështu parakushte për një sistem më efikas.

Buxheti vendor i vitit 2019 do të jetë buxheti me të cilin gjen zbatim të plotë ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, ku jo vetëm ka fonde më shumë sesa vitet e mëparshme, por ka

edhe një kuadër tashmë të plotë procedurash, rregullash dhe kriteresh të menaxhimit financiar vendor, çka garanton efektivitet dhe eficiencë në përdorimin e parave publike në nivel vendor.

Së fundi, dua ta mbyll fjalën duke u ndalur në dy momente të rëndësishme, që kanë të bëjnë me risqet potenciale që shoqërojnë buxhetin e vitit 2019 dhe mitigimin e tyre.

Së pari, lidhur me riskun e financimit të deficitit buxhetor dhe atij të rifinancimit të borxhit publik, dëshiroj të nënvizoj që nevojat për hua kanë ardhur duke u ulur gradualisht, duke reflektuar përmirësimin e strukturës së borxhit dhe reduktimin e riskut fiskal të qeverisë. Në harkun kohor të 5 vjetëve, huamarrja, në terma bruto, është bazuar mesatarisht në rreth 85% në burimet e brendshme të financimit, ku si instrument huaje janë përdorur titujt shtetërorë. Në dy vjetët e fundit, 2017 – 2018, ka pasur një rritje në favor të huamarrjes së huaj, kryesisht të realizuar në kuadër të shfrytëzimit të burimeve të favorshme të financimit të vëna në dispozicion nga institucionet financiare ndërkombëtare, si edhe shfrytëzimit të kushteve të favorshme të tregjeve ndërkombëtare në kuadër të mirëmanaxhimit të likuiditetit dhe detyrimeve të borxhit në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj rritjeve, ka ndikuar rritja e përqendrimit të huamarrjes së brendshme në titujt afatgjatë me norma interesi fikse të huamarrjes së brendshme në titujt afatgjatë me norma interesi fikse. Ndërkohë, në drejtim të optimizimit të kostove të përgjithshme të huamarrjes, ka ndikuar rënia e normave të interesit, shoqëruar me përqendrimin e një pjese të konsiderueshme të huamarrjes së huaj në burimet e financimit me natyrë dypalëshe dhe shumëpalëshe. Në këtë aspekt, vlen të përmendet se gjatë viteve të fundit jo vetëm kostot për njësi, por edhe kostot e përgjithshme të huamarrjes janë ulur ndjeshëm.

Së dyti, lidhur me risqet e tjera buxhetore, dua të theksoj se projektbuxheti i 2019-ës vijon të mbajë rezerva konsistente në krahun e shpenzimeve buxhetore në masën 0,7 % të totalit të shpenzimeve buxhetore 2019, ose rreth 4,3 miliardë lekë, të cilat, në vlerësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, do të absorbojnë mjaftueshëm probabilitetin e materializimit të risqeve, duke iu referuar goditjeve makroekonomike, realizimi më i ulët se parashikimi i të ardhurave buxhetore në potencë, kursi i pafavorshëm i këmbimit dhe normat e interesit më të larta se pritshmëria që ndikojnë shpenzimet për shërbimin e borxhit publik.

Për sa u përket risqeve buxhetore me natyrë implicite, do të rendisja sektorin elektroenergjetik, ku synohet një risk i ulët i ekspozimit të buxhetit ndaj këtij sektori, përmes ruajtjes së një rezultati neto, pra pozicionimi neto, siç iu referova më lart, të qëndrueshëm, që nuk rrezikon buxhetin për sektorët e tjerë prioritarë, pra 3 miliardë lekë në vit, mbajtjes së një rezerve

për përballimin e vulnerabilitetit ndaj kushteve meteorologjike të paparashikuara 1 deri në 3 miliardë lekë në vit.

Një risk implicit është ekspozimi i buxhetit ndaj pagesave të partneritetit publik-privat aktiv, ku për vitin 2019 dhe në vijim ky ekspozim do të jetë dukshëm brenda limitit ligjor, prej 5%, të totalit të të ardhurave buxhetore të vitit paraardhës, duke mbajtur një trend të lehtë rritës nga 3% në vitin 2019, në 3,4% në vitin 2021. Pra, siç e shikoni, gjithë diskutimi dhe debati i demonizimit të partneritetit publik privat nuk qëndron as nga ana fiskale, edhe për arsyen sepse qëndron thellësisht nën nivelin e paracaktuar me ligj, prej 5% të të ardhurave totale tatimore të vitit paraardhës.

Detyrimet kontigjente që kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave ndërkombëtare: Strasburgu dhe Arbitrazhi, por edhe ato të vendit, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për të cilat në buxhetin e vitit 2019 parashikohet që të përballohen nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, buxheteve respektive të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore të prekura nga këto vendime.

Risku tjetër është krijimi i detyrimeve të prapambetura, ku Ministria e Financave dhe Ekonomisë e ka intensifikuar rolin e saj monitorues dhe raportues, duke punuar fort për të informatizuar tërësisht procesin e menaxhimit të angazhimeve buxhetore nëpërmjet sistemit të ri të menaxhimit financiar, AFMIS, i cili pritet që të sjellë rezultate akoma edhe më domethënëse në eliminimin apo minimizimin e rasteve të krijimit të detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore ndaj të tretëve.

Në përfundim, dua t'ju risjell në vëmendje objektivat madhorë që synon të realizojë qeveria shqiptare nëpërmjet projektbuxhetit 2019. Është ai dhe, mbi të gjitha, i forcimit të rritjes ekonomike të vendit dhe konsolidimit fiskal, e theksoj këtë, pasi gjatë shqyrtimit të këtij projektbuxheti nga secili prej komisioneve parlamentare, çdo propozim alternativ duhet të mbajë parasysh ruajtjen e parametrave që lidhen me këta dy objektivë madhorë.

Faleminderit për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Para se të kalojmë në miratimin e kalendarit të propozuar nga Komisioni i Ekonomisë, do të falënderoj median për prezencën!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kaq ishte prezantimi. Tani mund të largoheni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka diskutime sot.

Atëherë, para keni një projektkalendar për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit dhe projektligjet financiare që kanë lidhje me të.

Zoti Braçe ka përgatitur një draft. Duke filluar nga sot deri në datën 3, kohë e cila është pak a shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, deri në 3 dhjetor.

Kjo kohë është më shumë se një muaj, afërsisht është, në mos gaboj, dy ditë më shumë sesa draftkalendarin e vitit të kaluar.

Dua të nënvizoj veçanërisht, madje t'u tërheq vëmendjen kryetarëve të komisioneve dhe nënkryetarëve, kur nuk ka kryetar komisionesh, se duhet të jenë rigorozisht të qartë për datat që duhet t'ia paraqesin raportin Komisionit të Ekonomisë, qoftë për diskutimin në parim, qoftë për diskutimin nen për nen. Pra, brenda datës 16 nëntor komisionet duhet të dërgojnë materialet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe raportin e tyre për diskutimin në parim të projektbuxhetit, pasi kemi pasur probleme më parë.

Njëherazi, edhe në funksion të datës 3 dhjetor, ka një lapsus në shtypje, është lënë data 23 nëntor (është bërë gabim kjo???), ndoshta mund të ishte data 28, jo 23-shi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, fillon më 23 dhe mbaron më 30, por data që komisionet do t'i përgjigjen Komisionit për Ekonominë dhe Financat me relacionet përkatëse për diskutimin nuk duhet të jetë data 23, sepse kjo është data e fillimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jetë data 28.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si jo?

Erion Braçe – Jo, sepse komisioni mund të ketë punë vetëm në datat 26 dhe 27, pasi datat 28, 29 dhe 30 nëntor, si dhe datat 1 dhe 2 dhjetor janë pushim. Data 3 dhjetor është e hënë. Kështu që...

Gramoz Ruçi – Atëherë, si do t'u bëka në datën 23, kur fillon diskutimi nen për nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Më falni, por nga data 16 deri në datën 23 komisioni mund ta shqyrtojë nen për nen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Në Komisionin e Ekonomisë brenda datës 23...

(Deputeti Balla flet pa mikrofon.)

Erion Braçe – Komisionit të Ekonomisë mund t'i dërgohen raportet deri në datën 23 për ndryshime, nëse do të ketë nen për nen.

Gramoz Ruçi – Keni të drejtë, se është nga data 16 nëntor...

Erion Braçe – Pa diskutim që Komisioni i Ekonomisë duhet të votojë...

Gramoz Ruçi – Mirë, por si do të bëhet kjo, Erion, sepse ti në datën 22 ke diskutimin në parim...

Erion Braçe – Po, komisioni mund të mblidhet.

Gramoz Ruçi – ...në datën 23 duhet të dorëzojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Patjetër, por komisionet mund të mblidhen, madje të bëjnë edhe diskutime nen për nen në kohën e gjatë që kanë në dispozicion nga kalendarit për shqyrtimin në parim. Nuk ka ndonjë problem këtu. Detyrimi është për Komisionin e Ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nuk ka problem për komisionin?

Erion Braçe – Jo, jo, nuk ka.

Gramoz Ruçi – Dakord, lëmë datën 23.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Mimoza Pano – Komisionet janë të orientuara që gjatë periudhës së shqyrtimit në parim të projektligjit dhe të paketës fiskale, që kanë një kohë shumë të gjatë, të punojnë edhe për shqyrtimin nen për nen. Kështu që ata do të përfundojnë një mbledhje për shqyrtimin në parim, do të përgatisin raportin për Komisionin e Ekonomisë...

Taulant Balla – ...nuk e di, por te pika 2 e kalendarit të sqarohet më qartë që krahas shqyrtimit në parim të projektligjit në komisionet e Kuvendit, komisionet me përjashtim të Komisionit të Ekonomisë, të bëjnë edhe shqyrtimin nen për nen.

Të jetë më e qartë kjo pjesë! Ekskluzivisht, pas datës 23, është vetëm Komisioni i Ekonomisë që bën shqyrtimin nen për nen, si dhe shqyrton të gjitha raportet e komisioneve të tjera.

Erion Braçe – Domethënë, që të jemi të qartë, data 27 nëntor është data e fundit e punës në Komisionin e Ekonomisë, gjë që do të thotë se më 27 nëntor ky komision duhet të votojë nën për nën ligjet e paketës fiskale dhe projektbuxhetin nën për nën, sepse pastaj fillon 1 javë me pushime. Datat 28, 29, 30, 1, 2 janë pushim. Dita e hënë, bile edhe dita e martë, kur do të votojmë ne, do të jetë pushim për administratën dhe administrata duhet të dalë në një nga ditët e pushimit, që pastaj të formalizojë secilin prej këtyre akteve.

Gramoz Ruçi – Po mirë, në javën që vjen pas të hënës, kur do të miratohet buxheti nuk do të ketë seancë dhe kështu, do ta kompensojnë pushimin edhe deputetët, edhe stafi.

Erion Braçe – Zoti Kryetar,

Është shumë e drejtë kjo që thoni ju, por problemi është se që tani deputetët kanë lajmëruar se nga data 28 e më pas mund të mos jenë, sepse do të jenë në terren.

Gramoz Ruçi – Do të jenë në terren?

Të shtrëngohen dhe t'i bëjnë gati.

Atëherë, sipas kësaj i bie që ta bëjmë diskutimin nën për nën në datën 27 dhe ta mbyllim këtu.

Erion Braçe – Çfarë t'ju them unë?

Jo, më 27 nëntor duhet ta votojmë ne, si komision.

Gramoz Ruçi – Atëherë, të biem dakord që më 23 nëntor relacionet e komisioneve të jenë te Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, seanca plenare do të jetë në datën 3, ditën e hënë.

Erion Braçe – Për ndryshimet nën për nën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rrofsh! Faleminderit!

Bëjeni për datën 17 nëntor, se ju deputetët e Tiranës e keni ditë feste.

Gramoz Ruçi – Atëherë, a biem dakord me kalendarin?

Do të nënvizoja 2-3 momentet e para. Sigurisht, nesër do të miratohet kalendarin. Nuk e di se kur do të startojë puna në komisione, por të gjitha komisionet që nga komisioni përgjegjës, që është Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe të gjithë ju, drejtuesit e komisioneve duhet të bëni menjëherë kalendarin tuaj për diskutimin e projektbuxhetit. Duhet t'i kushtohet shumë rëndësi kësaj me qëllim që të parashikoni se kur do të jenë ministrat e linjës, sipas përkatësisë, në komisionet tuaja, çfarë seancash dëgjimore duhet të bëni, kur do ta zhvilloni diskutimin në parim dhe kur do ta bëni diskutimin nën për nën!

Ju lutem shumë, veçanërisht juve që nuk jeni kryetarë, por jeni zëvendëskryetarë, të keni vëmendjen që merr apo nuk merr pjesë opozita, sepse ky është pozicion politik, diskutimi i ligjit për buxhetin dhe paketën fiskale që e shoqëron atë, duhet bërë me seriozitetin më të madh, si parashtrimi në komisione, si seancat dëgjimore, si debati në komisione, ashtu edhe përgatitja e relacioneve për Komisionin për Ekonominë dhe Financat dhe më pas, përgatitja për debatin në seancë plenare, si në parim ashtu edhe nën për nen.

Ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Stafi e ka shumëfishuar projektbuxhetin për deputetët?

Atëherë, nesër të jetë i shpërndarë! Nesër që në mëngjes do të merreni edhe me paketën fiskale.

Mimoza Pano – E kemi shpërndarë nëpër komisionet parlamentare, Kryetar.

Gramoz Ruçi – Dakord, e mora vesh. Po ju jap fletë lavdërimi për këtë. Bravo ju qoftë!

Nesër të merreni edhe me paketën fiskale, që do t’ju vijë që në mëngjes me qëllim që edhe kjo t’u shpërndahet të gjitha komisioneve dhe të gjithë deputetëve!

Jeni dakord?

Faleminderit!

Natën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA